REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 338/19
Datum 16.08.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 338/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej një anëtari individual z. Goran Milenković , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Telekomi i Kosovës" kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim dhe shërbime të internetit VPN për Universitetin publik Kadri Zeka- Gjilan" me nr prok: 941-19-4151-136, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Universiteti Kadri Zeka- Gjilan, më datën: 14. 08. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Telekomi i Kosovës" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime të internetit VPN për Universitetin publik Kadri Zeka- Gjilan" me nr prok: 941-19-4151-136, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan.

II.ANULOHET, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizim dhe shërbime të internetit VPN për Universitetin publik Kadri Zeka- Gjilan" me nr prok: 941-19-4151-136, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Universiteti "Kadri Zeka"- Gjilan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Telekomi i Kosovës" aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 17.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim: 18.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 19.06.2019

Me datën: 24.06.2019 OE "Telekomi i Kosovës" Sh.A - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan" me nr. prok. 941-19-4151-136 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti Publik "Kadri Zeka".

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 02.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues profesional në raportin e dt 04.07.2019, ka konstatuar:

Përgjigje në pretendimin 1.
Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9.4 të LPP-së (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur) për shkak se autoriteti kontraktues është autoritet publik dhe shërbimet e kërkuara poashtu ofrohen prej një operatori tjetër publik siç është "Telekomi i Kosovës" dhe në këto raste autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që shërbime të tilla nuk janë në dispozicion nga një autoritet publik, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues në këtë rast Universiteti "Kadri Zeka" është autoritet publik, po ashtu edhe "Telekomi i Kosovës" është autoritet publik, që të dy këto institucione janë pronë e qeverisë së Kosovës. Pikërisht për këto raste vlen nenin 9.4 i LPP-së i cili thotë:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"

Shtrohet pyetja logjike në zbatim të këtij neni të LPP-së, a është siguruar autoriteti kontraktues Universiteti "Kadri Zeka" që për furnizimet që ka prokuruar në këtë aktivitet të prokurimit, nuk janë në dispozicion të një autoriteti tjetër publik.

Në bazë të dokumenteve që ka në dispozicion eksperti shqyrtues përgjigje në këtë pyetje është jo. AK Universiteti "Kadri Zeka" nuk është siguruar që këto shërbime apo furnizime nuk janë në dispozicion në ndonjë autoritet tjetër publik. Kjo dëshmohet edhe me vet faktin që ka parashtruar ankesë, autoriteti tjetër publik "Telekomi i Kosovës" i cili ofron shërbime te tilla.

Për zbatim të kësaj dispozite ligjore, AK Universiteti "Kadri Zeka" duhet ti shfrytëzoj shërbimet dhe furnizimet që i ofron "Telekomi i Kosovës". Pavarësisht arsyetimit të AK Universiteti "Kadri Zeka" se kontrata e Telekomit e lidhur me Ministrinë e Administratës Publike nuk i ofron shërbimet e internetit VPN.

Pse qeveria, respektivisht ministria e administratës publike nuk ka pas nevojë për këto shërbime që ka tani Universiteti "Kadri Zeka", këto shërbime munden të ofrohen nga "Telekomi i Kosovës" vetëm për Universitetin "Kadri Zeka" dhe atë prej datës kur universiteti e përfundon kontratën aktuale.

Universiteti "Kadri Zeka" dhe "Telekomi i Kosovës" duhet të bashkëpunojnë detyrimisht për këto shërbime që i duhen universitetit dhe ti diskutojnë kushtet për kryerjen e shërbimeve në fjalë, qoftë edhe çmimet në bazë të një marrëveshje/kontrate të përbashkët. Por në asnjë mënyrë Universiteti "Kadri Zeka" nuk mundet të kontraktoj këto shërbime/furnizime me operator tjerë privat kur këto janë në dispozicon te operatorit publik siç është tani "Telekomi i Kosovës". Prandaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Autoriteti kontraktues me publikimin e njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, nuk e ka respektuar nenin 9 të LPP-së paragrafi 4.

Furnizimet/shërbimet që i duhen AK Universiteti "Kadri Zeka" sipas kësaj dispozite duhet të merren prej autoriteti publik që tani i ofron "Telekomi i Kosovës".

Bazuar në përgjigjeje e dhënë në pretendimin ankimor të OE ankues, si përfundim eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të Aprovohet si e bazuar.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon që autoriteti kontraktues Universiteti "Kadri Zeka" ta anuloj aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe shërbime të internetit, VPN për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan" me nr. prok. 941-19-4151-136 dhe këto furnizime/shërbime ti shfrytëzoj nga OE ankues "Telekomi i Kosovës" SH.A si autoritet publik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.08.2018, ku prezent kanë qenë paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK-së, përfaqësuesi i OE, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie te kontratës te aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së z. Ymeri i cili deklaroj: "Pajtohemi plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, dhe i propozojmë panelit të aprovohet ankesa jonë e bazuar".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së znj. Hasani e cila deklaroj: "Hapja ofertave për këtë tender është paraparë për 24.06.2019 mirëpo për shkak të ankesës të dërguar nga Telekomi i Kosovës është pezulluar aktiviteti dhe nuk është bërë hapja ofertave. Si institucion nuk kemi pas njohuri se ekziston një kontratë e lidhur mes MAP dhe Telekomit. Ne i kemi shkruar email zyrtar MAP dhe ASHI-së të cilët na kanë kthyer email zyrtar dhe na i janë dërguar kontratën, dhe na kanë njoftuar se kjo kontratë është e lidhur që nga data 29 Mars 2019 deri me 29 Mars 2020, kontratë kornizë tri vjeçare. Mirëpo ne kemi një kontratë të lidhur kornizë që aktualisht e shfrytëzojmë me një OE tjetër dhe kjo kontratë është e vlefshme deri me 17.01.2020. Nga kjo kemi vërejtur se ne kontratën e Telekomit mund ta përdorim për vetëm 2 muaj. Nga kjo kemi ardhë në konstatim se kjo kontratë nuk na hynë në punë vetëm për dy muaj dhe nuk mund ta përdorim një kontratë e cila është në përfundim. Këtë aktivitet që e kemi zhvilluar ka të bëjë vetëm me nevojat e shërbimit të internetit dhe VPN për universitet. Arsyeja pse kemi iniciuar aktivitetin që nga tani është se si AK nuk guxojmë të mbesim pa internet as një ditë të vetme.
I propozojmë panelit që ti lejohet AK-së hapja e ofertave dhe të merret vendim në favor të AK-së".

Gjatë prezantimit ne seance eksperti shqyrtues profesional z. Kurtishaj deklaroj: "Unë kam dhënë mendimin tim në ekspertizën e datës 04.07.2019, vetëm dua të shtoj se Universiteti Kadri Zeka ka nevojë për këtë shërbim të cilin ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit. Pavarësisht kontratës që Telekomi ka me MAP dhe pavarësisht kur përfundon dhe a ofron ajo shërbimin që i nevojitet AK-së, AK ka qenë dashtë ta konsultoj Telekomin a e ofron këtë shërbim që i nevojitet AK-së. Nëse Telekomi nuk e ofron shërbimin atëherë Universiteti ka mund të zhvilloj procedurën e prokurimit, mirëpo nëse Telekomi ofron një shërbim të tillë Universiteti ka obligim ligjorë të shfrytëzoj shërbimet e Telekomit dhe të negocioj kushtet e kontratës me Telekomin, ti shpreh gjitha shqetësimet duke përfshirë edhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve pa ndërprerje gjitha këto duhet diskutuar me Telekomin ashtu që AK të ketë vazhdimësi.
Çdo veprim tjetër i AK për të zhvilluar procedurë tjetër pa dhënë mendim Telekomi bjen në kundërshtim me nenin 9 të LPP-së siç kam potencuar në raport".

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Para se te bëhet ankesa nga Telekomi, përfaqësuesit e Telekomit kanë qenë në takim tek ne dhe na kanë njoftuar për kontratën që e kanë me MAP, e gjithashtu kemi vërejt se kontrata është në përfundim dhe kemi vërejt se shërbimet e VPN-së nuk na ofron. Ne i kemi kthyer përgjigjen edhe në kërkesë për rishqyrtim mirëpo ka qenë e drejtë e tyre të ushtrojnë ankesë. Duhet theksuar se kontrata mes MAP dhe Telekomit nuk përfshinë shërbimet e VPN. Si dëshmi ju ofroj kontratën e MAP dhe kontratën tonë që kemi deri me 17. 01. 2020".
Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "Përfaqësuesi i AK përmendi dy sende, kur kanë dërguar email në MAP dhe takimi mes zyrtarëve të AK-së dhe të Telekomit. Unë nuk i kam minutat e takimit mirëpo nuk pajtohem me AK-në se Telekomi nuk ofron VPN. Ne ofrojmë VPN pasi shumë institucione kanë VPN nga Telekomi i Kosovës, sipas nevojës së tyre. do thotë ne e ofrojmë këtë si shërbim. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi".

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankues për mosrespektim të nenit 9.4 të LPP-së, nga autoritetet kontraktuese ku ka sqaruar si në vijim: "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë

autoritet tjetër publik". Pra neni i lartcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është më se e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "blerje në shtëpi"). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-ës, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së".

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh faktin që Telekomi i Kosovës është autoritet publik dhe ofron shërbime profesionale të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit, dhe duke pasur parasysh faktin që AK-Universiteti publik "Kadri Zeka" si autoritet kontraktues nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së, atëherë ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të merret për bazë neni 9.4 i LPP-së.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, ankesës i ka bashkangjitur kopjen e shkresës, "Marrëveshje mbi shfrytëzimin e kontratës publike kornizë për ofrimin e shërbimeve Telekomunikuese të lidhur me Ministrin e Administratës Publike (MAP) dhe Telekomin e Kosovës"sha, me nr. prok: 202-16-102-215", ku objekt i marrëveshjes është ofrimi i shërbimeve të përshkruara si: Shërbimet - Telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kablli optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet e TV –kabllovik". Sipas përshkrimit, marrëveshja e njëjtë ka kohëzgjatje prej 36 muajve, përkatësisht nga data 01.04.2017, deri më datën 31.03.2020, Prandaj, sipas asaj që u përshkrua më lartë Autoriteti Kontraktues / Universiteti "Kadri Zeka" dhe Operatori Ekonomik ankues, "Telekomi i Kosovës" sha, për shërbimin e kërkuar përmes kësaj procedure të prokurimit (Shërbimet e internetit , televizionit kabllor), kanë marrëveshje deri më datën 31.03.2020. Andaj duke u nisur nga ky fakt paneli shqyrtues sqaron se, nëse Telekomi i Kosovës nuk arrin ta përmbush kontratën e cekur si më lart sipas kushte dhe kritereve te kërkuara nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë, autoriteti kontraktues mund ta shkëputë kontratën me ketë operator ekonomik sipas kushteve të parapara të kontratës ekzistuese dhe se marrëdhëniet e tyre kontraktuale palët ti rregullojnë nëpërmjet gjykatës kompetente sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore apo edhe ligjeve tjera në fuqi.

Në lidhje me deklarimet e përfaqësuesit të AK-së në seancën për shqyrtim kryesor se ata nuk kanë qenë në dijeni për marrëveshjen ekzistuese në mes të MAP dhe Telekomit të Kosovës dhe se të njëjtit tashmë kanë një kontratë të lidhur me një tjetër OE deri më datën 17.01.2020, paneli shqyrtues vlerëson se Universiteti "Kadri Zeka" dhe "Telekomi i Kosovës" duhet të bashkëpunojnë detyrimisht për këto shërbime që i duhen universitetit dhe ti diskutojnë kushtet për kryerjen e shërbimeve në fjalë, qoftë edhe çmimet në bazë të një marrëveshje/kontrate të përbashkët. Por në asnjë mënyrë Universiteti "Kadri Zeka" nuk mundet të kontraktoj këto shërbime/furnizime me operator tjerë privat kur këto janë në dispozicon te operatorit publik siç është tani "Telekomi i Kosovës".

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

REPUBLIKA E KOSOVËS
SHQYRTUESI I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
HOVA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Uni "Kadri Zeka"

1x1 OE- Telekomi i Kosoves sha

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.